



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri : KSC-BC-2020-06
**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 18 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i Kërkesës për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve,
dosja KSC-BC-2020-06/F0003 me datë 22 maj 2020**

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtës i Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtës i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtës i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëse e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

1. Më 25 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') kërkoi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të konfirmojë një aktakuzë kundër Hashim THAÇIT, Kadri VESELIT, Rexhep SELIMIT, dhe Jakup KRASNIQIT ('të dyshuarit').¹ Në atë kohë, ZPS-ja paralajmëroi gjithashtu parashtrimin e një kërkesë në të ardhmen lidhur me fletarrestime dhe masat përkatëse ('Kërkesa').²
2. Në pajtim me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës,³ ZPS-ja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të autorizojë një numër prej 9.000 fjalësh lidhur me kërkesën.⁴ Në rrethanat e posaçme aktuale, ekzistojnë arsye bindëse për këtë tejkalim, duke marrë parasysh rrethanat komplekse faktike dhe ligjore të përfshira në këtë kërkesë dhe nevojat përcjellëse të ZPS-së për parashtrime të njëmendta në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse të Ligjit⁵ dhe të Rregullores.⁶ Në lidhje me këtë, ZPS-ja synon të bëjë parashtrime dhe të kërkojë masa të shumëfishta lidhur me arrestimin dhe transferimin e katër të dyshuarve, kontrollimin dhe sekuestrimin, [REDAKTUAR] dhe mosnxjerrjen e aktakuzës dhe materialit lidhur me të.
3. Ky parashtrim dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullat 85(4) dhe 86(2).

Numri i fjalëve (në origjinal): 267

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E mërkurë, 18 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.

¹ Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim, KSC-BC-2020-06/F00002, 25 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte* (me tri shtojcat).

² KSC-BC-2020-06/F00002, para.5.

³ Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15, 17 maj 2019 ('Udhëzues Pune').

⁴ Norma për numrin e lejuar të fjalëve është 6,000 fjalë. *Shih* neni 41 i Udhëzuesit të Punës.

⁵ Ligji No.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji').

⁶ Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev2/2020, 5 korrik 2017 ('Rregullorja'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, çdo referencë për 'rregulla/rregullat' i referohet Rregullores.